

LIGJ
Nr. 157/2013

PËR MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT¹
(ndryshuar me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017; nr. 32, datë 17.6.2019)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton masat kundër financimit të terrorizmit, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin e tyre.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo të atyre, për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet bllokimit, sekuestrimit të fondeve e pasurive të tyre, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 3
Përkufizime

(ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 dhe pikës 2, zëvendësuar fjalë në pikën 3, shtuar pika 8 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

Në këtë ligj, përveçse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

¹Ligji nr. 157/2013, datë 10.10.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 29 tetor 2013.

Ligji nr. 43/2017, datë 6.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 21 prill 2017.

Ligj nr. 32, datë 17.6.2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 99, datë 10 korrik 2019.

1. "Blokim i përkohshëm" është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve e të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm.

2. "Sekuestrim" është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.

3. "Fonde dhe pasuri të tjera" janë pasuritë e çdo lloji, të përfshira, por pa u kufizuar në ato financiare, depozitat monetare, burimet ekonomike dhe pasuritë e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeket bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

4. "Terrorist" është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë një apo disa nga veprat e parashikuara në nenin 230 të Kodit Penal.

5. "Person që financon terrorizmin" është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, i çdo lloj forme apo emërtimi të regjistruar ose jo, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë një apo disa nga veprat e parashikuara në nenet 230/a dhe 230/b të Kodit Penal.

6. "Person i shpallur" është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, i çdo lloj forme apo emërtimi të regjistruar ose jo:

a) që është cilësuar dhe është përfshirë në listë si terrorist a person që financon terrorizmin, me vendim të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) i cili shpallet i tillë me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, rezolutave të tjera të nxjerra në zbatim të saj ose rezolutave të tjera të ngjashme, që lidhen me luftën kundër financimit të terrorizmit, në përputhje me procedurat e brendshme të parashikuara në këtë ligj.

7. "Person i interesuar" është çdo person që, në mirëbesim, ka ose pretendon se ka një të drejtë të ligjshme pronësie a pasurore në fonde dhe pasuri të tjera të personit të shpallur.

8. "Ngrirja e përkohshme" është ndalimi i transferimit, shndërrimit, disponimit apo lëvizjes së çfarëdo fondi ose pasurie tjetër të zotëruar apo kontrolluar nga personi ose enti i shpallur ku përfshihen:

a) të gjitha fondet apo pasuritë e tjera që zotërohen ose kontrollohen nga personi apo enti i shpallur dhe jo vetëm ato që mund të lidhen me një kërcënim, përgatitje apo akt terrorist të veçantë; dhe

b) ato fonde apo pasuri të tjera që tërësisht ose pjesërisht zotërohen apo kontrollohen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga personi apo enti i shpallur; dhe

c) fondet ose pasuritë e tjera të rrjedha apo të prodhuara nga fondet ose pasuritë e tjera që zotërohen apo kontrollohen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga personi apo enti i shpallur; si dhe

ç) fondet apo pasuritë e personave ose enteve që veprojnë për llogari të apo sipas orientimeve të peronave ose enteve të shpallura.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet ndaj personave të shpallur dhe personave, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes, për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara për përfshirje në çdo formë të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Përfshirja në listën e personave të shpallur

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, miraton listën e personave të shpallur dhe marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto rezoluta.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, të vendimeve të Bashkimit Europian apo vendimit të një shteti tjetër, që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij, mund të vendosë përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur. Këshilli i Ministrave mund të refuzojë përfshirjen në listë të personave, kur ky veprim:

- a) është në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik;
- b) rrezikon të cenojë sovranitetin, sigurinë kombëtare, rendin publik ose interesa të tjerë thelbësorë të shtetit.

Neni 6

Masa për fondet dhe pasuritë e tjera

(shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Ministri përgjegjës për financat, deri në miratimin me vendim të Këshillit të Ministrave për përfshirjen në listën e personave të shpallur, mund të urdhërojë bllokimin e përkohshëm për fondet ose pasuritë e tjera të personave, për të cilët ka filluar procedura e shpalljes dhe për të cilët ka dyshime të bazuara për përfshirje, në çdo formë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera apo që tentohet të kryhen, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave vendos për ndalimin për të kryer shërbime financiare, transaksione me fonde dhe pasuri të tjera personave të shpallur.

3. Ministri përgjegjës për financat urdhëron sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të shpallur nga Këshilli i Ministrave, të evidentuara e të verifikuara nga organet përgjegjëse.

4. Masat e parashikuara vendosen për të gjitha fondet dhe pasuritë e tjera, ku personi i shpallur ushtron të drejta pronësie, kontrolli ose të drejta apo interesa të tjerë, pavarësisht nga fakti se kush i ka në zotërim apo në përdorim fondet apo pasuritë e tjera, sikurse edhe për çdo fond e pasuri tjetër, që është gjetur në posedim ose mbahet nga persona të shpallur.

4/1. Të njëjtat masa merren edhe për fondet dhe pasuritë e tjera:

- a) në të cilat personi i shpallur ushtron të drejta kontrolli faktike;

b) që zotërohen apo kontrollohen nga personi i shpallur, duke mos i kufizuar masat për fondet dhe pasuritë e tjera që mund të lidhen me një akt terrorist specifik, komplot apo kërcënim;

c) që janë individualisht apo bashkërisht të zotëruara ose kontrolluara, direkt apo indirekt, nga persona të shpallur;

ç) të rrjedhura apo të krijuara nga fondet ose pasuritë e zotëruara apo të kontrolluara, direkt apo indirekt, nga personat e shpallur;

d) të personave që veprojnë për llogari ose nën drejtimin e personave të shpallur.

5. Zbatimi i masës së bllokimit të përkohshëm ose të sekuestrimit nuk pengon mbledhjen e interesave dhe marrjen e përfitimeve nga fondet dhe pasuritë e tjera. Këto masa shtrihen automatikisht edhe mbi fonde dhe pasuri të tjera që fitohen pas zbatimit të tyre.

6. Nuk lejohen veprime ose transaksione për fondet dhe pasuritë e tjera të bllokuara përkohësisht apo të sekuestruara, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe përcaktimeve të bëra në bazë të tij në aktin përkatës të bllokimit të përkohshëm ose të sekuestrimit.

KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE PËR TË BASHKËPUNUAR

Neni 7

Organet përgjegjëse për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit

(bequr fjalë në shkronjën "b", shtuar shkronja "b/1" me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Organet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të marra, të parashikuara në këtë ligj, janë:

a) Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për subjektet që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin;

b) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, për noterët;

b/1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

c) ministrinë apo autoritetet përkatëse, për institucionet në vartësi dhe për subjektet që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin, që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive të tjera.

2. Organet përgjegjëse, nëpërmjet inspektimeve, kontrollojnë përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin. Për qëllimin e këtij ligji, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, organet përgjegjëse mund të kërkojnë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloji informacioni e dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve, në zbatim të këtij ligji.

3. Organet përgjegjëse kryejnë edhe këto detyra:

a) kontrollojnë zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit nga subjektet dhe sigurohen se këto masa janë të përshtatshme;

b) informojnë në kohë dhe bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për çështjet e mospërputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve të tyre, masat përmirësuese që do të merren dhe masat administrative, nëse ka pasur;

c) bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe ofrojnë asistencë të specializuar, sipas veprimtarisë së tyre, në fushën e zbatimit të masave kundër financimit të terrorizmit;

ç) përgatitin dhe shpërndajnë programe trajnimi për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Mbledhja dhe administrimi i të dhënave

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave merr masa për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për:

a) personat e shpallur apo personat, për të cilët është filluar procedura e brendshme e shpalljes;

b) fondet dhe pasuritë e tjera që disponojnë ose lidhen me të drejta ose interesa të tjerë të personave të shpallur apo në procedurë të brendshme për shpallje.

2. Mbledhja, përpunimi, analiza, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit, sipas këtij ligji, bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Neni 9

Shkëmbimi i të dhënave

(shtuar fjalë me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017)

Ministri përgjegjës për financat, ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, ministri përgjegjës për punët e jashtme, ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë, ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, sipas fushës dhe përgjegjësi, shkëmbejnë informacione dhe të dhëna në nivel kombëtar e ndërkombëtar për personat e shpallur, për të cilët ka dyshime të bazuara për përfshirje, në çdo formë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, ose për të cilët ka filluar procedura e brendshme e shpalljes.

Neni 10

Detyrimi për raportim

(shtuar fjalë në pikën 1, zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Subjektet apo institucionet raportuese, të parashikuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, janë të detyruara të raportojnë menjëherë, pa njoftim paraprak të personave të dyshuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave kur kanë të dhëna ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste, pavarësisht nga vlera e tyre.

2. Çdo person që ka dijeni për veprime financiare, transaksione, fonde ose veprime të tjera, të kryera apo që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen apo financimin e veprave terroriste, është i detyruar që, pa njoftim paraprak dhe përfshirje të personave të dyshuar apo të prekur, të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

3. Njoftimi dhe raportimi duhet të përmbajnë të dhëna për identifikimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të dhëna për pronësinë dhe interesa të tjerë rreth tyre, si dhe shpjegime për motivet ku mbështeten të dhënat e arsyeshme për financim të terrorizmit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kur ka arsye të bazuara në fakte apo rrethana konkrete për financim terrorizmi, i propozon menjëherë ministrit përgjegjës për financat bllokimin e përkohshëm për fondet dhe pasuritë e tjera.

Neni 10/1

Ngrirja e përkohshme

(shtuar me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Subjektet, institucionet dhe personat e parashikuar në nenin 10, të këtij ligji, si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë, ngrijnë përkohësisht fondet apo asetet e tjera të personave ose enteve të shpallura, në mënyrë të drejtpërdrejtë, sapo marrin dijeni për shpalljen nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, pa u kushtëzuar nga nxjerrja e urdhrit të bllokimit të përkohshëm apo vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Ndalohet vënia në dispozicion të personave apo enteve të shpallura nga strukturat përkatëse, sipas pikës 1, të këtij neni, të enteve të zotëruara apo kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë prej tyre dhe të personave apo enteve që veprojnë për llogari apo sipas orientimeve të personave apo enteve të shpallura, të fondeve apo pasurive të tjera, burimeve ekonomike, shërbimeve financiare apo të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pjesërisht apo tërësisht.

3. Ndalohet njoftimi paraprak i personave të shpallur, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe të interesuar apo prekur, sipas pikës 2, të këtij neni, për ngrirjen e përkohshme.

4. Të dhënat e plota për rastet e ngrirjes së përkohshme, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë, i njoftohen menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila jep udhëzimet e nevojshme.

5. Vendimet e strukturave përkatëse, sipas pikës 1, të këtij neni, kanë fuqi të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme, i njoftohen zyrtarisht subjekteve të parashikuara në nenin 10, të këtij ligji, si dhe publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

6. Zbatimi i masës së ngrirjes së përkohshme vijon deri në daljen e urdhrit të bllokimit nga ministri përgjegjës për financat, sipas parashikimeve të këtij ligji.

7. Rregullat dhe procedura më të detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Mbrojtja e identitetit

Organet që marrin raportime, sipas nenit 10 të këtij ligji, janë të detyruara të ruajnë identitetin e personave, subjekteve raportuese dhe të punonjësve të tyre që kanë raportuar.

Neni 12

Ndalimi i publikimit të të dhënave

1. Të dhënat e siguruar në zbatim të këtij ligji mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të ligjit, për qëllime të ndjekjes penale ose për qëllime të tjera, të caktuara me ligj.

2. Organet përgjegjëse, subjektet raportuese dhe personat e punësuar pranë tyre, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, nuk mund të bëjnë publike fakte, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë ose për shkak të detyrës.

3. Organet përgjegjëse, subjektet raportuese dhe personat e punësuar pranë tyre detyrohen t'i vënë në dispozicion gjykatës dokumentet e kërkuara, si dhe të dëshmojnë vetëm në rastet e lejuara, sipas nenit 160 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13

Mbrojtja e personave, subjekteve apo organeve përgjegjëse në mirëbesim

Personat, subjektet, drejtuesit, zyrtarët dhe punonjësit e subjekteve, të përkohshëm apo të përhershëm, që përbushin ose kërkojnë të përbushin në mirëbesim detyrimet, sipas dispozitave të këtij ligji, janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale, civile ose administrative, që vjen si shkak i njoftimit apo i raportimit.

KREU III

HARTIMI I LISTËS SË PERSONAVE TË SHPALLUR DHE MARRJA E MASAVE KUNDËR FONDEVE DHE PASURIVE TË TJERA

Neni 14

Procedura e shpalljes, mbështetur në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

(ndryshuar pika 1, zëvendësuar fjalë në pikën 3, shtuar pika 4 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Ministri përgjegjës për punët e jashtme, menjëherë dhe jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen në listën e personave të shpallur, duke njoftuar, njëkohësisht, organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative dhe ministrin përgjegjës për financat, i cili miraton bllokimin e përkohshëm për fondet dhe pasuritë e tjera të këtyre personave, nëse ka të dhëna për ekzistencën e tyre brenda vendit.

2. Përcaktimet e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përbëjnë të dhëna të bazuara se personi është terrorist ose person që financon terrorizmin.

3. Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e parë të radhës nga marrja e propozimit nga ministri përgjegjës për punët e jashtme, vendos për përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur.

4. Në rastet e listimit, sipas këtij neni, ndiqen procedurat dhe formularët standardë për listim, të miratuara nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

Procedura e brendshme e shpalljes

(shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017; shtuar fjalë në pikën 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative, ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave që, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre, kanë marrë dijeni ose kanë dyshime të bazuara në indicie për përfshirje personash, në çdo formë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet personave të tjerë fizikë dhe juridikë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera apo që tentohet të kryhen, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara t'i propozojnë menjëherë ministrin përgjegjës për financat përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur, si dhe marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj.

1/1. Procedura dhe standardet e parashikuara në këtë nen ndiqen edhe në rastet e propozimeve për listim të kërkuara sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji.

2. Për shqyrtimin e rasteve të propozuara, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, ministri përgjegjës për financat mund të thërrasë një komitet të posaçëm këshillimor, me përfaqësues në nivel të lartë drejtues nga ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për

çështjet e drejtësisë, ministria përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Banka e Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit.

3. Ministri përgjegjës për financat mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave përfshirjen e personave të propozuar sipas pikës 1 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.

4. Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit nga ministri përgjegjës për financat, mund të vendosë për përfshirjen e personave apo subjekteve të propozuara nga ministri përgjegjës për financat, sipas pikës 3 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.

Neni 16

Blokimi i përkohshëm

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017; zëvendësuar fjalë në pikën 1 dhe 2, shtuar shprehje në fund të fjalës së dytë në pikën 2 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Ministri përgjegjës për financat urdhëron, pa njoftim paraprak, bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera, përpara nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, kur kjo është e vetmja mënyrë për të parandaluar shmangien nga zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj dhe duhet të njoftojë Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për efekt të procedimit të mundshëm penal.

2. Urdhri i ministrit përgjegjës për financat për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 45 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas nxjerrjes së urdhrit. Ky urdhër u komunikohet për zbatim organeve përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, si dhe subjekteve të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 17

Ankimi kundër bllokimit të përkohshëm

1. Kundër urdhrit të ministrit përgjegjës për financat për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera, personit të interesuar i lind e drejta të bëjë ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja e dëgjimit.

2. Gjykata e shqyrton çështjen brenda 10 ditëve, duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast, ankimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të urdhrit të ministrit përgjegjës për financat.

3. Personi i interesuar ka detyrimin të provojë para gjykatës se:

a) ka një të drejtë të ligjshme në fondet dhe pasuritë e tjera të personit, të përcaktuara në urdhrin e ministrit përgjegjës për financat;

b) ka burime të justifikuar ligjërishit për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera;

c) fondet dhe pasuritë e tjera, objekt gjykimi, nuk kanë lidhje me terroristë, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur me ta.

4. Personi i interesuar quhet i njoftuar për urdhrin e ministrit përgjegjës për financat duke filluar nga data kur ka marrë dëgjimin. Në çdo rast, çështja shqyrtohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 18

Vendimi i Këshillit të Ministrave

(ndryshuar pika 4, shtuar pika 5 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme apo ministrit përgjegjës për financat, vendos miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur, për të cilët zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë, u komunikohet organeve përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Ministri përgjegjës për financat, brenda 5 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave, njofton ministrin përgjegjës për punët e jashtme për personat e shpallur me indicie brenda vendit.

4. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, pas marrjes së njoftimit, sipas pikës 3, të këtij neni, informon strukturat përkatëse pranë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas afateve dhe modaliteteve të përcaktuara prej tyre, duke ndjekur format, procedurat dhe/ose kërkesat e strukturave përkatëse në lidhje me informacionin e kërkuar për identifikimin e personave të shpallur dhe të lidhur me ta, të dhëna për rastin dhe arsyet e propozimit, si dhe nëse statusi i vendit, si propozues, mund të bëhet i njohur. I njëjti standard të dhënash dhe procedure, për aq sa është e zbatueshme, përdoret edhe në rastet kur i kërkohet një vendi tjetër marrja e masave për bllokim të përkohshëm apo sekuestrim, sipas parashikimeve të këtij ligji.

5. Kërkesa për shpallje pranë strukturave përkatëse në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dërgohet në rastet kur rezulton se ka shkaqe të arsyeshme që krijojnë dyshimin për përfshirjen e personit ose subjektit përkatës, për të cilin kërkohet shpallja në vepra të terrorizimit ose të financimit të tij. Kërkesat e bëra në përputhje me këtë pikë duhet të bëhen pa njoftim paraprak të personit apo subjektit përkatës.

Neni 19

Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave

1. Personi i shpallur, në bazë të listave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, mund të bëjë ankim kundër vendimit të Këshillit të Ministrave në gjykatën kompetente brenda 15 ditëve nga marrja dijeni. E drejta e ankimit mund të ushtrohet vetëm në rastin kur personi pretendon se është identifikuar gabimisht me personin e shpallur.

2. Për dëmet e shkaktuara, në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nuk mund të kërkohet dëmshpërblim nga shteti shqiptar, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me qëllim apo me faj.

3. Personi i shpallur, sipas pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji, mund të bëjë ankim kundër vendimit të Këshillit të Ministrave në gjykatën kompetente brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

4. Gjykata e shqyrtton çështjen duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast, ankimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

Neni 20

Pavlefshmëria e veprimeve mbi fondet dhe pasuritë e tjera

Veprimet apo transaksionet e kryera mbi fondet dhe pasuritë e tjera, pas hyrjes në fuqi të

urdhrit të bllokimit të përkohshëm apo vendimit të Këshillit të Ministrave, janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 21

Verifikimi i identitetit, i fondeve dhe i pasurive të tjera

(zëvendësuar fjalë në pikën 2 dhe 3 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike bën verifikimin e identitetit të personave që u nënshtrohen procedurave si person i shpallur, apo për të cilët është filluar procedura e shpalljes dhe janë evidentuar fonde e pasuri të tjera.

2. Organet përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, menjëherë nga njohja me vendimin e Këshillit të Ministrave, ua përcjellin për zbatim institucioneve të varësisë, subjekteve që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin.

3. Institucionet e varësisë apo subjektet, menjëherë nga njoftimi, verifikojnë dhe raportojnë tek organi përgjegjës përkatës për fondet dhe pasuritë e tjera, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose ku ata kanë ndonjë të drejtë apo interes tjetër.

4. Fondet dhe pasuritë e tjera, për të cilat nuk ka qenë e mundur të evidentohen brenda afateve të mësipërme, raportohen menjëherë pas evidentimit tek organi përgjegjës përkatës.

5. Organet përgjegjëse, menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e njoftimit nga institucionet e varësisë, subjektet që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin, i paraqesin Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave një raport me shkrim, ku jepen të dhënat që personi i shpallur ka të drejta dhe interesa në fondet dhe pasuritë e tjera.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit nga organet përgjegjëse për fonde dhe pasuri të tjera të evidentuara, i propozon ministrit përgjegjës për financat nxjerrjen e urdhrit të sekuestrimit.

Neni 22

Sekuestrimi i fondeve dhe pasurive të tjera

(ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, ministrit përgjegjës për financat, brenda 5 ditëve nga marrja e propozimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nxjerr urdhër për sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të tjera dhe kalimin në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Urdhri hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet personit të shpallur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Urdhri i ministrit përgjegjës për financat i dërgohet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe institucioneve, subjekteve e organeve përgjegjëse, në të cilat janë evidentuar fonde dhe pasuri të tjera, të cilat marrin masa për ekzekutimin e menjëhershëm të këtij urdhri.

3. Pas vendosjes së masës të sekuestrimit, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ushtron të gjitha të drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, përfshirë posedimin, administrimin dhe veprime të tjera, që i çmon të nevojshme.

4. Procedurat dhe rregullat e marrjes në administrim, shpenzimet për administrim dhe kthim të fondeve e pasurive të tjera të sekuestruara rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Neni 23

Shpenzime të lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera

(shtuar pika 4 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Ministri përgjegjës për financat, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, autorizon pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara për t'i përdorur për nevoja jetese, mjekësore, familjare dhe vetjake të personit të shpallur, për pagimin e detyrimeve ndaj shtetit ose të atyre që rrjedhin nga puna e kryer dhe sigurimet e detyrueshme.

2. Kundër urdhrin të ministrit përgjegjës për financat për refuzimin e autorizimit të kërkuar mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente, brenda 5 ditëve nga marrja dajeni.

3. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim të veçantë, vendos rregulla dhe procedura të hollësishme për shpenzimet e lejueshme, duke pasur parasysh kriteret e parashikuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

4. Autorizimi për shpenzimet e lejuara, sipas këtij neni, kryhet pasi të jenë realizuar procedurat dhe kërkesat përkatëse, të vendosura nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 24

Ankimi ndaj urdhrin të sekuestrimit

1. Personat e shpallur dhe personat e interesuar, që pretendojnë se janë në mirëbesim, mund të bëjnë ankimi ndaj urdhrin të ministrit përgjegjës për financat për sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të tjera në gjykatën kompetente jo më vonë se 30 ditë nga marrja dajeni për këtë urdhër sekuestrimi. Në çdo rast, ankimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të urdhrin të sekuestrimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

2. Personat e interesuar, që pretendojnë se janë në mirëbesim, zbatojnë detyrimet e parashikuara në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 25

Ndryshimi dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur

(zëvendësuar fjalë në pikën 1, shtuar shkronja "e" në pikën 4, shtuar pikat 4/1 dhe 4/2, zëvendësuar fjalë në pikën 5 me ligjin nr. 32, datë 17.6.2019)

1. Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e vendimit për listën e personave të shpallur brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit të ministrit përgjegjës për financat, ministrit përgjegjës për punët e jashtme, kërkesën e personit të shpallur ose të personit të cenuar gabimisht, të shoqëruar me shpjegimet për ndryshimin e rrethanave përkatëse, që kanë motivuar nxjerrjen e tij.

2. Ministri përgjegjës për punët e jashtme, mbështetur në ndryshimet dhe revokimet në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, brenda 5 ditëve nga publikimi i tyre, i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimin ose revokimin e personave nga lista e personave të shpallur, duke njoftuar njëkohësisht ministrin përgjegjës për financat.

3. Ministri përgjegjës për financat, mbështetur në propozimet e organeve dhe institucioneve të parashikuara në pikën 1 të nenit 15 të këtij ligji, ose në vlerësimet e komitetit të posaçëm këshillimor, i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimin ose revokimin e personave nga lista e

personave të shpallur.

4. Ndryshimi ose revokimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për listën e personave të shpallur bëhet kur vërtetohen rrethana dhe fakte, që e bëjnë të panevojshëm zbatimin e mëtejshëm të tij:

a) për shkak të një vendimi të mëvonshëm të strukturave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji;

b) për shkak të një detyrimi që i kërkohet ose i lind Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

c) për shkak të një vendimi përkatës të organizatave të tjera ndërkombëtare, të Bashkimit Europian ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

ç) për shkak të vendimit të heqjes nga lista të personit nga vendi që ka kërkuar shpalljen;

d) për shkak të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, të marrë pas ankimit të personit të shpallur, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 19 të këtij ligji;

dh) kur kanë ndryshuar rrethanat, faktet dhe arsyet, për të cilat është bërë shpallja, sipas nenit 15 të këtij ligji;

e) për shkak të kërkesës së bazuar të personave të cenuar gabimisht nga masat e parashikuara në këtë ligj.

4/1. Ministri përgjegjës për punët e jashtme publikon procedurat për dërgimin e kërkesave për heqje nga lista, drejtuar strukturave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me procedurat dhe kriteret e vendosura nga këto struktura.

4/2. Në rast se Këshilli i Ministrave vlerëson se personi apo subjekti i shpallur nuk i plotëson kriteret e shpalljes apo të vijimit të përfshirjes së tij në listat përkatëse, ministri përgjegjës për punët e jashtme, në përputhje me procedurat e miratuara nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, paraqet kërkesë për heqjen nga lista e shpalljes.

5. Heqja e masës së sekuestros ndaj fondeve dhe pasurive të tjera të personave të shpallur, si rezultat i ndryshimit ose i revokimit të listës për personat e shpallur, kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.

6. Kur hiqet masa e sekuestros ndaj fondeve dhe pasurive të tjera, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frutat e pasurisë, të realizuara gjatë administrimit. Ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin në masën e pakësimit të vlerës së pasurisë ose të dëmit që, me faj, i është shkaktuar pasurisë.

Neni 26

Procedimi penal dhe pasuror

Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave procedurale penale apo atyre të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara, në zbatim të këtij ligji.

KREU IV SANKSIONET

Neni 27

Kundërvajtjet administrative

1. Nëse nuk përbën veprë penale, mospërmbyshja nga organet përgjegjëse dhe subjektet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Autoritet përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të ligjit me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për masat kundër financimit të terrorizmit është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

3. Dënimet administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, vendosen nga ministri përgjegjës për financat, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Procedurat e shqyrtimit, ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28

Dispozita kalimtare

1. Aktet nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, do të mbeten në fuqi, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

2. Ky ligj zbatohet edhe për vepra penale të terrorizmit, si dhe për fondet e pasuritë e tjera që kanë shërbyer për financimin e terrorizmit, të kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të pikës 4 të nenit 22 dhe të pikës 3 të nenit 23 të këtij ligji.

Neni 30

Dispozitë shfuqizuese

Ligji nr. 9258, datë 15.7.2004, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, shfuqizohet.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.10.2013

Shpallur me dekretin nr. 8367, datë 28.10.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani.